



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 170 , Datë 07.11.2019

MBI

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SA’GA MAT” SH.P.K., PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË LUAJTSHME TË ARDHSHME APO TË TASHME DHE VENDOSJEN E HIPOTEKËS MBI ASETEDET E PALUAJTSHME, QË DO TI PËRKASIN HEC-VE “GERMAN 1” DHE “GERMAN 2”, NË FAVOR TË BANKËS “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SH.A., PËR EFEKT TË DHËNIES SË KREDISË PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT TË VEPRAVE HIDROENERGJITIKE “GERMAN 1” DHE “GERMAN 2”.

Në mbështetje të nenit 16; nenit 44, pika “1”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 6, nenit 7 dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 të “Kushteve të Licencës së prodhimit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016, nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 101/2 Prot., datë 31.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k., për lënie në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të Bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.,

Konstatoi se:

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 623 datë 03.10.2019, 623/1 Prot., datë 07.10.2019 dhe 623/2 Prot., datë 22.10.2019, shoqëria “SA’GA MAT” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për lënie peng të aseteve të luajtshme të ardhshme apo të tashme dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme, që do t’i përkasin HEC-ve “German 1” dhe “German 2”, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.”, për efekt të dhënies së kredisë për financimin e ndërtimit të veprave hidroenergjitike “German 1” dhe “German 2”.
- Kjo shoqëri, është krijuar *Në zbatim të kontratës së Koncesionit të formës BOT të dhënë nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës e autorizuar nga Këshilli i Ministrave, për shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike, me shfrytëzimin e rrjedhjes ujore të përroit zalli i Germanit, Rrethi Mat.*

- Shoqëria “SA’GA MAT” sh.p.k., është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 247, Seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 92, datë 06.10.2014, për një periudhë 30 vjeçare dhe modifikuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 6, datë 17.01.2019 nga HEC-et: “GERMANI 1” me kapacitet të instaluar 1200 kw, “GERMANI 2” me kapacitet të instaluar 1680 KW, “GERMANI 3” me kapacitet të instaluar 1290 KW, “GERMANI 4” me kapacitet të instaluar 810 KW, me kapacitet total të instaluar 4980 KW, për shkak të optimizimit të skemës hidroenergjitike duke përmirësuar projektin. Shoqëria aplikuese, është gjithashtu mbajtëse e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, me nr. 254, Seria T14P, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 103, datë 07.11.2014.
- Aplikimi plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në *“Rregulloren për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”*, si më poshtë:
 - **Neni 7 pika 1 gërmat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” “f”, “g” “h” “i” dhe “j”**, janë plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Neni 7 pika 3**, (Subjektet koncensionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të asetëve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të asetëve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncensionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (MEI) në lidhje me qëllimin e transferimit të asetëve). Plotësuar pjesërisht.
 - Shoqëria ka depozituar në ERE marrëveshjet, në të cilat, saktësohen detyrimet që marrin përsipër palët për shkak të marrëveshjes së koncensionit dhe pjesët që transferojnë të përfituesi. Gjithashtu, shoqëria “SA’GA – MAT” sh.p.k., ka përcjellë bashkëlidhur aplikimit të saj kërkesën drejtuar MIE me nr. 03 Prot., datë 22.08.2019 *“Kërkesë për njohjen e Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. si palë financuese dhe njohjen e të drejtës së “Zëvendësimit të Koncesionit” sipas nenit 12 pika 12.6.1 dhe 12.6.2 të Kontratës së Koncesionit nr. 83/61 datë 10.01.2011 (Kontrata koncensionare formës BOT (ndërtim – shfrytëzim – transferim) për ndërtimin e Hidrocentraleve “Germani 1”, “Germani 2”, “Germani 3”, “Germani 4”, “Germani 5”)*, si dhe shkresën drejtuar Autoritetit Kontraktues nga Pala Financuese të datës 30.09.2019, *“Kërkesë për miratim të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. si palë financuese të shoqërisë koncensionare “SA’GA’MAT” sh.p.k. së bashku me të gjitha të drejtat që ligji dhe kontrata i njeh si palë financuese;*
 - Para se ERE të shprehet mbi kërkesën e aplikuesit, do të kërkojë që ky i fundit të depozitojë në ERE qëndrimin e MIE në lidhje me kërkesën për njohjen e Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. si palë financuese dhe njohjen e të drejtës së “Zëvendësimit të Koncesionit” sipas nenit 12 pika 12.6.1 dhe 12.6.2 të Kontratës së Koncesionit nr. 83/61 datë 10.01.2011.
 - Shoqëria koncensionare “SA’GA-Mat” sh.p.k. ka përfunduar ndërtimin dhe vënien në punë të HEC-it “Germani 1”, në Tetor të vitit 2018.

- Rezulton se, shoqëria ka filluar shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga HEC“Germani 1”, në përputhje me kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike lidhur me OSHEE-n, me afat vlefshmërie 15 vjet.
- HEC-i “Germani 2” është aktualisht në fazë ndërtimi.
- Shoqëria ka bërë me dije se arsyeja e kërkesës për miratimin e penglënies së aseteve të shoqërisë, është për të garantuar financimin, me objekt ndërtimin e hidrocentraleve “Germani 1” dhe “Germani 2”, sipas objekteve të kontratave që ka nënshkruar më Bankën Intesa Sanpaolo.
- Në kushtet që, sipas të deklarimeve të aplikuesit, por edhe të dhënave që disponon ERE, Hidrocentrali German 1, rezulton i ndërtuar e vënë në punë, objekti i kontratës së nënshkruar me Bankën Intesa Sanpaolo rezulton me cen, duke mos reflektuar saktë statusin e objektit sipas veprimtarisë për të cilin është licencuar Subjekti aplikues, e që lidhet me HEC “German 1”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SA’GA - MAT” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme të ardhshme apo të tashme dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme që do t’i përkasin HEC -it “German 1”, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për efekt të dhënies së kredisë për financimin e ndërtimit të veprës hidroenergjitike “German 1”.
2. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SA’GA - MAT” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme të ardhshme apo të tashme dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme që do t’i përkasin HEC-it “German 2”, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për efekt të dhënies së kredisë për financimin e ndërtimit të veprës hidroenergjitike “German 2”.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI